

Blloku politik, LDK, AAK, Nisma dhe në rast të hyrjes së “Vetëvendosjes” në qeveri po synon që ndarjen e ministrive ta bëjë sipas fuqisë politike që kanë.

LDK-ja thotë se i takon numri më i madh i ministrive, LVV-ja deklaron se do ta marrë çerekun e dikastereve, kurse AAK-ja dhe Nisma thonë se nuk i kanë bërë ende kalkulimet.

Ndarja e “kulaçit” për ndërtimin e qeverisë së ardhshme që synohet të krijohet nga partnerët e koalicionit, LDK, AAK dhe NISMA në rast të hyrjes eventuale të Vetëvendosjes, do të bëhet sipas fuqisë politike. /Zëri/